



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

Numri i lëndës: 2022:105201  
Datë: 24.12.2024  
Numri i dokumentit: 06650319

K.DH.SH.II.nr.310/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KOSTT- Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a, me numër unik identifikues 811284512, me seli ne rr.”Isa Boletini” nr.39 ne Prishtinë, ndaj debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2371/22 dt.27.12.2023, me datën 24.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me seli ne Bulevardin “Bill Klinton” ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 2371/22 dt.27.12.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës– Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2371/22 dt.27.12.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit pjesërisht ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me seli ne Prishtinë, ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor te Përmbaruesit Privat Driton Govori Prishtinë P.nr.80/2022 dt.06.05.2022, për pjesën e detyrimit kryesor për shumën prej 18,124,893.70 euro dhe për këtë pjesë ka përfunduar procedurën përmbarimore. Ne pjesën në II te dispozitivit te këtij aktvendimi ka refuzuar pjesërisht si te pabazuar prapësimin e debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, me seli ne Prishtinë dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.80/2022 dt.06.05.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Driton Goivori Prishtinë, sa i përket kamatës ne lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor si ne piken I te dispozitivit si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë aktvendimin e atakuar ta anuloj ose ndryshoj dhe propozimin për përmbartim ta refuzoj për pjesën e dytë në lidhje me kamatëvonesën dhe shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KOSTT- Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a, me numër unik identifikues 811284512, me seli në rr. "Isa Boletini" nr.39 në Prishtinë, me datën 06.05.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) sha, në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.957 me nr. Prot.65 dt.18.01.2022, note debitnr.051-Korrigjim i faturës nr.0957 nr.prot.189 dt.23.02.2022, fatura nr. 0960 me nr.Prot.66 dt.18.01.2022, note kredit nr.444 korrigjim i faturës 138 nr.prot.33 dt.31.01.2022 . Përmbartuesi Privat Driton Govori Prishtinë, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.80/2022 dt.06.05.2022 ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat, në afat prej 7 ditësh pune nga dita e pranimit të faturës, t'ia paguaj shumën prej 18,124,893.70 euro, me kamatë vjetore 4.5% vjetore sipas rregullave të tregut, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 16.05.2022, përmes së cilit pretendon se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar proceduara përmbartimore nuk është dokument i besueshëm dhe se kushti i përcaktuar në dokumentin përmbartues nuk është përmbushur përveç nëse parashikohet me ligj. Debitori në këtë rast i referohet edhe Raporteve konsultative sa i përket të hyrave nga KEDS, Komenteve mbi këto raporte, Raporteve të shqyrtimit të hyrave, planeve të veprimit mbi krizën energjetike dhe dokumenteve tjera të Qeverisë sa i përket masave emergjente. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta anuloj dhe ta obligoj kreditorin të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 19.05.2022, me arsyetimin se asnjë nga pretendimet e debitorit në prapësim nuk paraqet bazë nga neni 71 i LPP, KOSTT ka iniciuar propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm faturave të cilat janë në pajtim me nenin 29 par.1.3 të LPP. Pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë dhe nuk janë objekt i trajtimit në procedurën përmbartimore dhe si të tilla nuk paraqesin shkak për prapësim, andaj

propozon qe gjykata ta refuzoj si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes ne prapësim dhe pas mbajtjes se seancës dëgjimore, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2371/22 dt.27.12.2023, me të cilin e ka përfunduar procedurën përmbarimore sa i përket kryegjësë ne shumen prej 18,124,893.70 euro ndërsa ka refuzuar prapësimin e debitorit sa i përket pjesës lidhur me kamatëvonesën vjetore për kryegjënë dhe shpenzimet procedurale, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka konstatuar se nga shkresat ne lëndë nuk është kontestues se debitori ka përmbushur detyrimin nga borxhi kryesor prej 18,124,893.70 euro dhe se ky borxh është përmbushur pas lejimit te urdhrin përmbarimor nga përmbaruesi privat, përmes pagesave te datave 12.08.2022, 17.08.2022, 24.08.2022 dhe 09.08.2022, por se debitorit nuk e ka paguar kamatën ne vlere prej 4.5% siç është përcaktuar me propozimin për përmbarim,. Gjykata konstaton se kreditori ka theksuar se tërhiqet pjesërisht nga propozimi për përmbarim sa i përket kryegjësë ne vlerën prej 18,124,893.70 euro ndërsa urdhri përmbarimor mbetet ne fuqi sa i përket kamatëvonesës se përcaktuar ne lartësi prej 4.5% nga data kur kërkesa është bere e arritshme e deri ne pagesën definitive. Gjykata i referohet nenit 69 dhe 71 te LPP. Gjykata ka vendosur si ne pjesën e II te dispozitivit te aktvendimit përkitazi pagesës se kamatës prej 4.5%, pasi kjo lartësi e kamatës është kontraktuar nga palët dhe se e njëjta është pasqyruar ne faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarimi. Gjykata i referohet nenit 382 par.1 dhe nenit 383 te LMD, dispozitave nga neni 2 pika 1.33 dhe 1.34 te Ligjit 05/L-037 për TVSH dhe nenit 47.1 te TVSH, ndërsa ne lidhje me shpenzimet e procedurës vendosi ne kuptim te nenit 13.4 te LPP te ndryshuar me ligjin 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-139 për procedurën Përmbarimore. Prandaj pretendimet e debitorit se dokumenti mbi bazën e te cilave shet lejuar përmbarimi nuk përbejnë dokumente te besueshme dhe se debitorit nuk është përgjegjës për pagesën e kamatës ase kontraktuar vlerësoi se nuk qëndrojnë se këto pretendime nuk qëndrojnë si edhe [pretendimi se vonesa ne përmbushjen e detyrimit nuk duhet ti atribuohet debitorit, për shkak te forcës madhore por gjykata ka vlerësuar se meqë procedura përmbarimore i nënshtrohet parimit te rigorozitetit formal sipas se cilës ne këtë procedurë nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera por vetëm vlerësimi i përshtatshmërisë e dokumentit mbi te cilin është lejuar përmbarimi, andaj edhe ka vendos si ne dispozitiv te aktvendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes, ngase me shikimin në shkresat e lëndës gjegjësisht deklarimet e palëve ne seancën dëgjimore te dt.18.12.2023 dhe Njoftimit te datës 19.08.2022 nga Përmbaruesi Privat Driton Govori, drejtuar Gjykatës Komerciale, se Kreditori KOSTT përmes parashtresës me nr.prot.1645 dt.18.08.2022, njofton Përmbaruesin Privat se debitori ka paguar një pjesë nga detyrimi i tij ne shumen prej 15,000,000.00 euro dhe atë përmes transfereve bankare ne Raiffeisen Bank, te datave 17.08.2022 shumen prej 5,000,000.00, 12.08.2022 ne shumen prej 5,000,000.00 dhe me datën 09.08.2022 ne shumen prej 5,000,000.00 euro. Po ashtu kreditori

KOSTT me datën 29.08.2022 përmes Përmbauesit Privat Driton Govori, njofton Gjykatën Komerciale se debitori përmes parashtrësës së datës 26.08.2022, ka njoftuar se me datën 24.08.2022 ka paguar shumën e mbetur të detyrimit kryesor në vlerën prej 3,124,893.70 euro, duke përmbushur kështu në tërësi borxhin kryesor ndaj kreditorit, ndërsa ka mbetur pa u paguar kamata ligjore nga data e arritshmërisë së pagesës sipas afatit në fatura, andaj përfundimin juridik të gjykatës e shkallës së parë në lidhje me përfundimin e procedurës përmbauese sa i përket detyrimit të kryegjësë e përkrah në tërësi kjo gjykatë, shtoj kësaj edhe faktin se kreditori në seancën dëgjimore ka deklaruar se tërheq pjesërisht propozimin përmbauesor vetëm sa i përket detyrimit për borxhin kryesor por jo edhe kamatëvonesës dhe shpenzimeve të procedurës përmbauese, bazuar në dispozitat ligjore dhe atë nën 42 të LPP .

Edhe kjo gjykatë vlerëson faktin se meqë në faturat si dokument mbi bazën e të cilave është lejuar përmbauesi kreditori ka precizuar kamatëvonesën prej 4.5% vjetore dhe fakti se debitori ka përmbushur borxhin nga kryegjësja, rezultojnë se tani më debitori ka në obligim kamatëvonesën si dhe shpenzimet e procedurës ndaj kreditorit e kjo bazuar edhe në faktin tjetër se debitori përmbushjen detyrimit kryesor e ka bërë pas inicimit të procedurës përmbauese nga ana e kreditorit.

Në lidhje me këtë çështje edhe kjo gjykatë vlerëson nën 382 par.1 të LMD i cili parasheh që *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”* ndërsa nën 384 par.1 i LMD parasheh që *“Kreditori ka të drejtë në kamatëvonesën pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonësës së debitorit”*, ashtu që konsiderojnë që përfundimi juridik i gjykatës e shkallës së parë është i drejtë dhe ligjor.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, pranon në tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nën 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nënit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë analizon edhe pretendimet ankimore të debitorit se vonesa në përmbushjen e detyrimit është për shkak të forcës madhore dhe se debitori nuk duhet të mbahet përgjegjës sa i përket kamatëvonesës dhe shpenzimeve të procedurës, por këto pretendime kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara dhe paargumentuara me prova konkrete prandaj të njëjtat i refuzoi ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nënit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.310/24, me datë 24.12.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova